



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.
më _____. _____. 2019

Elbasan,

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: **“Inpress”sh.p.k.** me adrese: Rruga "Siri Kodra", ish blloku magazinave, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje shtypshkrime për administratën e Bashkisë Elbasan, drejtorinë e SHMZSH –së dhe gjendjen civile” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 15 muaj, me fondi limit 2,447,382 (dymilion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa t.v.sh., vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2019 dhe 2020. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Shumatorja e çmimeve për njësi: 13,323 (trembëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë pa tvsh.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 12631-03-06-2019

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Rama - Graf” sh.p.k me Nipt: K 42701205 E

Shumatorja e çmimit për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është 8,368 (tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë (pa tvsh).

2. “Inpress” sh.p.k me Nipt: L 52122014 L

Shumatorja e çmimit për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është **9.540,28** (nëntë mijë e pesëqind e dyzet presje njëzet e tetë) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Rama - Graf” sh.p.k me Nipt: K 42701205 E

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertuesi **“Rama - Graf” sh.p.k**, skualifikohet për arsye se: me vendimin nr.398/2019 datë 25.06.2019 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi të skualifikoje operatorin ekonomik **“Rama - Graf” sh.p.k** pasi argumentimi i ofertës anomalisht të ulët nuk është sjellë në përputhje të plotë me nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për **“Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”**, i ndryshuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Inpress” sh.p.k me Nipt: L 52122014 L

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **9.540,28** (nëntë mijë e pesëqind e dyzet presje njëzet e tetë) **lekë** (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.07.2019

Ankesa ka patur.

Ka patur ankesë nga operatori ekonomik **"Rama - Graf" sh.p.k**. Autoriteti kontraktor pas shqyrtimit të ankesës, me vendimin nr. 2088/14 prot. datë 23.07.2019 vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik **"Rama - Graf " sh.p.k**. Ky vendim ju komunikua operatorit ekonomik **"Rama - Graf " sh.p.k** më datë 24.04.2019. Operatori ekonomik **" Rama - Graf" sh.p.k** nuk e dërgoi ankesën për shqyrtim në Komisionin e Prokurimit Publik.

TITULLARI I AUTORITETIT

KONTRAKTOR

PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ

Zv.Kryetari

Vesa Liço